



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1600, datë 22.04.2011

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1492, datë 10.02.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.04.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1492, datë 10.02.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a” të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projektakti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, pretendimet**);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1492, datë 24.01.2011 i KD të AKEP “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a”;
2. Shkresë Albtelecom sh.a nr.779 Prot, datë 14.02.2010 (AKEP: nr. 289 prot, datë 14.02.2011) “Mbi depozitimin e pretendimeve të Albtelecom sh.a mbi mosmarrëveshjen me Vodafon AL sh.a ”;
3. Shkresë e Vodafone AL sh.a nr shkresën nr. ref. CEO/027/Exh datë 10.03.2011 (AKEP: nr. 102/3 prot, datë 10.03.2011), “Parashtrimet e operatorit Vodafone Albania sh.a në lidhje me procedimin administrativ të AKEP mbi mosmarrëveshjen me palë (VKD nr. 1492, datë 24.01.2011)”;
4. Seanca dëgjimore e zhvilluar me datë 03.03.2011 në selinë e AKEP midis palëve;
5. Korrespondencat shkresore dhe me email midis palëve e depozituara nga Vodafone AL sh.a dhe Albtelecom sh.a;
si dhe
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen,
7. Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R Ë N:

- I. Sipërmarrësi Albtelecom sh.a me shkresën nr.779 prot, datë 14.02.2010 (AKEP: nr. 289 prot, datë 14.02.2011) “Mbi depozitimin e pretendimeve të Albtelecom sh.a mbi mosmarrëveshjen me Vodafon AL sh.a ”, paraqet në mënyrë të përmbledhur argumentat ligjore dhe teknike si më poshtë:
 1. Skema funksionale e interkoneksionit e paraqitur edhe në MI me secilin nga operatorët mobile të interkonektuar me Albtelecom, interkoneksioni realizohet me centralet tranzite të Albtelecom;
 2. Refuar topologjisë dhe arkitektures së rrjetit të Albtelecom dhe shkallës së hierarkisë së centraleve të interkoneksionit, lidhja në centralet tranzite përcakton terminimin në segment të dyfishtë, duke patur parasysh parimin ligjor të mbulimit të kostove që

Albtelecom i shkaktohen për ofrimin e shërbimit të terminimit për operatorët e telefonisë së lëvizshme;

3. Albtelecom aplikon terminimin në segment lokal njëfish dhe dyfish;

II. Sipërmarrësi Vodafone AL, me shkresën nr. ref. CEO/027/Exh datë 10.03.2011 (AKEP: nr. 102/3 prot, datë 10.03.2011), “Parashtrimet e operatorit Vodafone Albania sh.a në lidhje me procedimin administrativ të AKEP mbi mosmarrëveshjen me palë (VKD nr. 1492, datë 24.01.2011)”, paraqet në mënyrë të përmbledhur argumentat ligjore dhe teknik si më poshtë:

1. Vodafone konsideron se argumenti i Albtelecom sipas të cilit, topologjia e rrjetit të tij dhe shkalla e hierarkisë së centraleve të interoneksionit përcakton terminimin në segment të dyfishtë, për të mbuluar kostot e terminimit të Albtelecom për terminimin e thirrjeve celulare, është një argument i pabazuar në Ligj.

Për sa më sipër Vodafone konsideron se kostoja e interoneksionit përcaktohet nga faktorë objektivë si elementët e rrjetit, sasia e trafikut që terminohet etj, Gjithashtu, thekson se ende nuk ka asnjë përfundim se cilat janë kostot e Albtelecom për terminimin në rrjetin e tij.

Vodafone në lidhje me strukturën e tarifave të terminimit për Albtelecom vlerëson se mbështetet në bazë të parimit të vendndodhjes gjeografike të pikës fundore të thirrur, por edhe të centralit që mundëson interkoneksionin;

2. Albtelecom pretendon se struktura me segmente lokale, njëfish dhe dyfish vlen vetëm për operatorët alternativë që janë autorizuar të operojnë në zona të caktuara gjeografike, në bazë të numeracionit përkatës të miratuar nga AKEP. Vodafone konsideron se ky pretendim provon që struktura e tarifave të terminimit udhëhiqet thjesht nga parimi i vendndodhjes gjeografike të pikës fundore që thirret në rrjetin e Albtelecom;

3. Vodafone, pretendimin e Albtelecom se tarifat e terminimit në rrjetin e Albtelecom kanë qënë në vijimësi më të ulëta se kostot efiçente të ofrimit të këtyre shërbimeve, e konsideron në shkelje të neneve 7, 53, 55, 57, dhe 59...ku Albtelecom pranon se është një operator jo-efiçent dhe se operon nën kosto;

4. Albtelecom pranon se po përmirëson teknogjinë e tij për të mundësuar një terminim më efiçent të thirrjeve, por nga ana tjetër insiston që të paguhen tarifa terminimi që janë jo-efiçente, gjë e cila është në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit nr. 9918;

5. Për sa më sipër Vodafone konsideron se:

- Nuk ka pse të paguajë tarifa më të shtrenjta sepse Albtelecom nuk planifikon rrjetin në mënyrë efiçente;
- Struktura e tarifave të terminimit është e zbatueshme për çdo operator që sjell thirrje për terminimin në rrjetin e Albtelecom pa diskriminim celular apo fiks;
- Përcaktimi nëse një thirrje është për terminim lokal apo kombëtar ka të bëjë thjesht me kriterin gjeografik (vendodhja e pikës fundore të thirrur dhe vendodhja e pikës së interkoneksionit);

- Albtelcom nuk mund të pretendojë një tarifë të caktuar mbështetur në argumenta kostoje për sa kohë që nuk ka një metodologji kostoje të miratuar formalisht nga AKEP);
- 6. Vodafone në përputhje me përcaktimet e rregullores “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, i kërkon AKEP të ndërmarr masat rregullatore si më poshtë kërkohet:
 - Mbështetur në pikën 4.5.2.ii të VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 “Për përcaktimin e Albtelcom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”, kërkon që AKEP të detyrojë Albtelcom të zbatojë këtë Vendim dhe të pranojë zbatimin e tarifës së terminimit rajonal prej 2.5 lek/min për të gjitha thirrjet e origjinuara në rrjetin e Vodafone të terminuara në centralin rajonal të Albtelcom bazuar në vendndodhjen gjeografike të pikës fundore në rrjetin e Albtelcom ku terminohet thirrja;
 - AKEP t’i imponojë Albtelcom detyrimin për të mos zbatuar tarifë për thirrje, duke qënë se tarifa për kohëzgjatje është në bazë për minutë. Tarifa për thirrje përbën diskriminim të hapur ndaj operatorëve celular që nuk u njihet një tarifë e tillë sipas edhe Vendimeve më të fundit për operatorët celularë nga AKEP;
 - AKEP të lëshojë një Urdhër për lidhjen e Marrëveshjes së interkoneksionit midis Vodafone Albania dhe Albtelcom në përputhje me përcaktimet e nenit 60 të Ligjit nr. 9918, date 19.05.2008, “ Për komunikimet elektronike dhe postare”;
 - së fundmi Vodafone Albania kërkon që një mënyrë e tillë tarifimi e diferencuar të pasqyrohet edhe në ORI-n e ri të Albtelcom që duhet të miratohet sa më parë nga AKEP;

III. AKEP, në seancën dëgjimore të mbajtur në selinë e AKEP me datë 03.03.2011, midis palëve në procedim vëren se:

- Të dy palët kanë kërkuar që në vijim të seancës dëgjimore të Komisionit të Mosmarrëveshjes të kenë mundësinë e një seance dëgjimore nga KD i AKEP, para marrjes së vendimit për mbylljen e procedimit administrativ të nisur me VKD nr.1492 datë 24.01.2011.
- Vodafone ka mbrojtur argumentin se meqënëse pika e interkoneksionit Vodafone-Albtelcom është në Tiranë, Vodafone duhet të përfitojë tarifë terminimi lokale ose njëfish për thirrjet drejt abonentëve të Albtelcom që ndodhen në Tiranë. Vodafone ka pranuar tarifë terminimi dyfish ndër vite, por me ndryshimin e kushteve të tregut dhe rritjen e tarifave të terminimit të Albtelcom kërkon që të aplikohet tarifa e terminimit lokale dhe/ose njëfish për Tiranën.
- Palëve ju është sqaruar nga AKEP se në RIO aktuale të Albtelcom tarifa e terminimit të aplikuar varet nga lloji i pikës së interkoneksionit në të cilin është lidhur operatori: një operator mund të përfitojë tarifë terminimi lokal për thirrjet drejt abonentëve të Albtelcom të lidhur me centralin lokal përkatës nëse operatori është i lidhur në atë pikë lokale interkoneksioni.
- Albtelcom është shprehur se nuk ka mundësi teknike të pranojë trafik në centrale lokale nga OC. Në rast të tillë për Tiranën, OC duhet të lidhen në secilin prej tre centraleve lokale

të Albtelecom në Tiranë. Dhe në rast të tillë, Albtelecom do t'i duhet të rrisë kapacitete e këtyre centraleve, gjë e cila do të ishte e përkohshme dhe investimi shtesë do të shkonte dëm, pasi struktura e rrjetit Albtelecom po shkon drejt NGN/NGA.

- Vodafone është shprehur se për Albtelecom duhet të aplikohen tarifat e terminimit sipas kostove BULRAIC ashtu si dhe për operatorët celularë. Mos aplikimi i tyre përbën diskriminim ndaj operatorëve celularë, për të cilët AKEP ka marrë tashmë vendim për aplikimin e rezulateve të modelit BULRAIC.
- Albtelecom ka sjellë në vëmendje Rregulloren e Akses Interkoneksionit miratuar me VKD 1300 neni 5, pika 5. Gjithashtu Albtelecom është shprehur se nëse Vodafone kërkon aplikimin e segmenteve për terminimin në Albtelecom, për simetri edhe Vodafone duhet të aplikojë segmente terminimi për thirrjet brenda qytetit.
- Palët janë sqaruar se për aplikimin e tarifave të Albtelecom sipas kostove BULRAIC do të veprohet si me telefoninë celulare dhe do të zhvillohet një konsultim publik së shpejti nga AKEP.

IV. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:

1. Interkoneksioni në rrjetin fiks të operatorit inkumbent Albtelecom është përcaktuar nga AKEP të realizohet në tre nivele, lokal, njëfish dhe dyfish, dhe në bazë të segmentit përkatës aplikohen dhe tarifat përkatëse të terminimit të thirrjeve. Aplikimi i segmenteve të terminimit varet nga lidhja midis pikës së interkoneksionit ku dorëzohet thirrja dhe vendndodhjes së pajtimatrit në rrjetin e Albtelecom. Këto përcaktime janë dhënë në faqet 5-8 të RIO-s së Albtelecom të miratuar me vendimin e AKEP nr.630, date 10.02.2009, si më poshtë:

Pikë interkoneksioni kombëtare që ndodhet (apo lidhet me) në centralet tranzit kombëtare në Tiranë dhe Durrës dhe shërbejnë për interkoneksion me rrjetin Albtelecom për terminimin e thirrjeve drejt gjithë përdoruesve të rrjetit Albtelecom dhe për tranzitimin e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera të interkonektuar me Albtelecom.

Pikë interkoneksioni rajonale që ndodhet (apo lidhet me) në central tranzit rajonal të Albtelecom dhe shërbejnë për interkoneksion me rrjetin Albtelecom për terminimin e thirrjeve drejt gjithë përdoruesve të rrjetit Albtelecom dhe për tranzitimin e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera të interkonektuar me Albtelecom.

Pikë interkoneksioni lokale që ndodhet (apo lidhet me) në central lokal të Albtelecom dhe shërbejnë vetëm për terminimin e thirrjeve drejt përdoruesve fundore të Albtelecom që janë të lidhur me këtë central lokal.

Terminim në segment lokal: terminimi i thirrjeve që dorëzohen në pikë lokale interkoneksioni dhe terminohen tek përdoruesit e Albtelecom, seritë numerike të të cilëve i përkasin centralit lokal në të cilën ndodhet pika e interkoneksionit.

Terminim në segment njëfish: terminimi i thirrjeve që dorëzohen në pikën e interkoneksionit rajonale dhe terminohen tek përdoruesit e Albtelecom, seritë numerike të

të cilëve i përkasin centraleve lokale të lidhur me centralin rajonal në të cilin ndodhet pika e interkoneksionit.

Terminim në segment dyfish: terminimi i thirrjeve që dorëzohen në pikën e interkoneksionit dhe terminohen tek përdoruesit e Albtelecom seritë numerike të të cilëve i përkasin centraleve lokale të lidhur me një central rajonal të ndryshëm nga centrali rajonal në të cilën ndodhet pika e interkoneksionit.

2. Përkufizimet dhe sqarimet e mësipërme janë pjesë e RIO të Albtelecom të miratuar me VKD nr.630, datë 10.02.2009, dhe prevalojnë mbi përkufizimet e dhëna në seksionin Përkufizime në të njëjtin dokument, pasi përmbajnë sqarime më të detajuara të segmenteve të terminimit dhe pikave të interkoneksionit të Albtelecom. Gjithashtu, sqarimet apo detajimet e mësipërme janë dhënë edhe në dokumentat e analizave të tregut në 2007 dhe 2010 për telefoninë fikse si dhe janë përputhje me praktikën ndërkombëtare të ndarjes së segmenteve të terminimit në rrjet fikse.
3. Ndarja e segmenteve të terminimit dhe pikave të interkoneksionit të Albtelecom është bërë në analogji me tarifën e thirrjeve brenda rrjetit Albtelecom : lokale, rajonale dhe kombëtare.
4. Për sa më sipër, një operator mund të perfitojë:
 - a. terminim lokal: vetëm për thirrjet që dorëzohen në pikën lokale të interkoneksionit dhe që terminohen tek abonentët e lidhur me centralin lokal përkatës: thirrje drejt abonentve që kanë numra që shërbejnë nga ky central lokal. Pika lokale e interkoneksionit pranon thirrje vetëm drejt këtyre numrave.
 - b. Terminim segment njëfish: vetëm për thirrjet që dorëzohen në një pikë rajonale interkoneksioni dhe që kanë destinacion abonente në central lokale që janë të lidhur me këtë central rajonal. Pika rajonale mund të përdoret edhe për të dërguar thirrje drejt rajoneve të tjera, dhe në këtë rast tarifa e terminimit është segment dyfish.
 - c. Në rast se thirrja dorëzohet në një pikë kombëtare interkoneksioni, tarifa që duhet të paguhet është terminim në segment dyfish, pavarësisht se pika kombëtare e interkoneksionit dhe pajtimtari i Albtelecom ku terminohet thirrja mund të jenë në të njëjtin qytet apo zonë lokale për tarifimin retail.
5. Në bazë të argumentave të Albtelecom ndër vite rezulton se për shkak të teknike të menaxhimit të rrjetit, rrugëzimi i thirrjeve që dorëzohen në pikat lokale të interkoneksionit kryhet jo në centralin lokal, por nëpërmjet centraleve tranzite kombëtare: thirrja dorëzohet në pikë lokale interkoneksioni dhe me pas Albtelecom dërgon thirrjen në një nga dy centralet transit kombëtare (Tiranë ose Durrës) dhe kjo thirrje kthehet në centralin lokal ku terminohet tek pajtimtari. Kjo skemë aplikohet edhe për thirrjet e dorëzuara në central rajonal. Këto skema

megjithese perfshijnë rrugesim te thirrjeve me te madh se terminimi lokal apo nfish (pra dhe koso me te larte), aplikohet per thirrjet e operatoreve alternative pa kosto shtese per keta operatore. Ky tarifim eshte imponuar nga AKEP duke u bazuar ne rendesine qe kane segmentet e tarifimit te terminimit ne aftesisne kokurruese te operatoreve alternative me Albtelecom ne sherbimet telefonike ne nivelin me pakice te telefonise fikse, sidomos te thirrjeve lokale. Ky detyrim ishte pjese edhe e Projekt-RIO te Albtelecom ne fund te vitit 2010, varianti final i se ciles eshte ne process vendim-marrje nga AKEP. Gjithahshtu ne kete variant, eshte konkluduar qe segmenti lokal i terminimit te jete i disponueshem vetem per thirrjet e abonenteve te OA dhe jo per thirrjet e tranzituara (hyrese nderkombetare). Ne baze te RIO te propozuar nga Albtelecom, thirrjet hyrese nderkombetare dhe nga rrjetet celulare do te pranohen vetem ne pika kombetare interkoneksioni, pra dhe me tarife ne segmet dyfish. Propozimi i Albtelecom eshte mbeshtetur ne Rregulloren e Akses Interkoneksionit (neni 5, pika 5):

Marrëveshjet e interkoneksionit dhe ofertat e referencës mund të përmbajnë rregulla të cilat parashikojnë që disa tipe të caktuara të thirrjeve të telefonisë me zë duhet të dorëzohen në disa pika të caktuara interkoneksioni.

6. Historikisht OC jane interkonektuar vetem ne central transit kombetar me Albtelecom dhe kane paguar tarife terminimi segment dyfish. RIO e vitit 2009 nuk pengon OC te lidhen ne pika te tjera interkoneksioni si lokale dhe rajonale, megjithate ne MI-t e nenshkruara sipas kesaj RIO operoret kane rene dakort me pike kombetare interkoneksioni.
7. Parimisht tarifat e terminimit dhe aksesit ne pika interkoneksioni nuk varen nga origjina e thirrjes: fiks apo celulare, dhe operoret celulare kane te drejte te perfitojne tarifa lokale dhe/ose nfish nëse ata interkonektohen ne pika lokale dhe/ose rajonale interkoneksioni. Tarifimi kryhet sipas percaktimeve te dhena me siper dhe RIO te Albtelecom.
8. Ndërkohë përvec përcaktimit në pikën 5 të nenit 5 të Rregullores se Aksesit dhe interkoneksionit (cituar më sipër), sipas pikes 2 te nenit 6 te kësja rregulloreje, operatori ofrues mund te refuzoje dhenien e aksesit operatorit perfitues (ne kete rast Vodafone Albania) per nje sherbim te caktuar (në këtë rast akseis në pikë lokale/rajonale interkoneksioni), vetëm në bazë të kriterëve objektive si pamundëshmëria teknike apo nevoja për të ruajtur integritetin e rrjetit dhe ai ka detyrim ta provojë pamundësinë e ofrimit të këtij shërbimi. Argumentat e Albtelecom për mos-dhënie aksesit në pikë lokale/rajonale interkoneksioni janë dhënë në pretendimet e dërguara për këtë procedim administrativ (njëkohësisht edhe në diskutimet e kryera për RIO e Albtelecom në 2008-2009), të cilat gjykohen se janë të pjesshme pasi Albtelecom nuk ka dhene detaje dhe afate te kalimit ne NGN/NGA, megjithese ka filluar tashme kete ndryshim te rrjetit.

9. Dhenia nga Albtelecom e aksesit ne pika lokale/rajonale interkoneksioni per OC ka avantazhe dhe disa disavantazhe per OC, Albtelecom dhe tregun:
- a. Perfitimi i tarifave te terminimit lokal/rajonal zvogelon detyrimet neto te OC per trafikun e terminuar apo edhe te tranzituar ne Albtelecom por per te perfituar akses ne pika lokale/rajonale inetrkoneksioni operatoret celulare se pari do te duhet te bejne lidhje shtese ne keto pika. Aktualisht OC jane te lidhur ne centralin transit kombetar ne Tirane dhe per te perfituar terminim lokal duhet te lidhen ne centralin perkates lokal (per qytetin e Tiranës ne TR1 dhe TR2), madje edhe per terminim njefish ne Tirane do te duhet te lidhen ne centralin rajonal te Tiranës (ky central mund te jete ne te njejten vendndodhje me centralin transit kombetar Tirane por do kete kosto shtese te lidhjes me pjesen rajonale te centralit).
 - b. Lidhja e OC me pika lokale/rajonale interkoneksioni jashte Tiranës, ne kushtet kur secili OC ka MSC vetem ne Tirane, do te conte ne rrugesime te thirrjeve jo eficente: thirrja e nje abonenti celular nga nje rreth do te vije ne MSC-Tirane dhe me pas do te shkoje perseri ne piken e interkoneksionit te OC me Albtelecom ne kete rreth. Ne kete rast rrugesimi i thirjes nga OC drejt kesaj nyje ne rrjetin Albtelecom kryhet nga OC dhe qe normalisht ka kosto me te larte se rrugesimi nga Albtelecom.
 - c. Albtelecom do te duhet te investoje ne centralet lokale kapacitete dhe aftesi shtese. Sipas Albtelecom keto investime do te dalin jashte perdorimit per nje kohe te shkurter per shkak te kalimit ne NGN/NGA. Ky argument gjykohet nga AKEP se eshte i vlefshem per investimet ne centralet lokale por per centralet rajonale gjykojme se ato do te sherbejne ende si pika nyje ne rrjetin NGN per rrjetin e transmetimit.
 - d. Ne rast se reduktimi neto i detyrimeve te OC i kalon abonentëve fundore per tarifa me te uleta drej Albtelecom, atehere perfitojne edhe konsumatoret. Megjithate bazuar ne historikun e tarifave celulare si dhe pjesen e vogel qe ze terminimi fiks ne tarifen me pakice celulare drejt fiksit, si dhe peshen e vogel te thirrjeve celular-fiks ne thirrjet e perdoruesve celulare, ky perfitim eshte pak i mundshem (madje eshte pak e mundshme te filloje aplikimi i tarifave celulare drejt fiks me zona lokale rajonale dhe kombetare. Kjo te conte ne tarifa me diferenca absolute shume te vogla 1-2 lek/minute krahasuar me rreth 20 leke/minute te thirrjes aktuale.
10. Niveli aktual i tarifës se terminimit ne segment dyfish si edhe segmentet e tjera te terminimit ne Albtelecom jane te perkoheshme dhe pritet qe ato te reduktohen brenda vitit 2011.
11. AKEP vlerëson se Albtelecom duhet te jape akses ne segment dyfish (akses ne central transit kombetar) dhe segment njefish per rajonin e Tiranës. Aksesit ne piken rajonale te interkoneksionit per Vodafone do te duhet te kryhet nepermjet nje lidhje te re ne centralin rajonal te Tiranës midis Vodafone dhe Albtelecom, sipas percaktimeve te RIO dhe tarifave ne fuqi te Albtelecom.

12. Per kërkesat e tjera të Vodafone për heqjen e tarifave për thirrje të Albtelecom, pasi tarifave të reja të OC nuk e përmbajnë këto tarife, si dhe reflektimin në RIO të re të tarifave të diferencuara, AKEP ka dhënë sqarimet në procesin orientimit në kosto të tarifave celulare, si edhe sqarim se orientimi në koston BULRAIC të tarifave të Albtelecom dhe RIO të re të Albtelecom janë në proces vendim-marrjeje nga AKEP. Për orientimin në koston të tarifave të Albtelecom do të zhvillohet një konsultim publik siç u veprua për operatorët celularë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1492 datë 03.12.2010 "Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a.
2. Albtelecom të plotësojë kërkesën e Vodafone Albania për dhënie të aksesit në pikën rajonale të interkoneksionit në Tiranë, përveç aksesit në pikën kombëtare të Interkoneksionit.
3. Tarifat, modalitetet dhe afatet e implementimit të pikës së re të interkoneksionit midis palëve të jenë sipas ofertës referencë në fuqi të Albtelecom dhe vendimeve të AKEP.
4. Të njoftohen palët e interesuara Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**